



Prishtinë, 31 janar 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1480_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15 , Nenin 25, Nenit 26 dhe nenin 42 paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenit 8 paragrafët 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Rregullës Nr. 03/2020 dhe Metodologjisë për Përgatitjen e Bilanceve të Energjisë;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 12.10.2021 për shqyrtim dhe aprovim të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike për vitin 2022,

në seancën e mbajtur me datë 31 janar 2022, nxori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET - Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike për vitin 2022.

II. Zyra e Rregullatorit për Energji do të monitorojë implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë elektrike si në dispozitivin nën pikën I. të këtij Vendimi, për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 12 tetor 2021 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2022** nga KOSTT Sh.A.
- o Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike paraqet planin vjetor të shpenzimit të energjisë elektrike në raport me energjinë elektrike në dispozicion. Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike bazohet në nevojat e planifikuara të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2022, i cili është parashikuar të furnizohet nga gjenerimi vendor dhe importi i energjisë elektrike. Po ashtu në bilanc parashikohet edhe eksportimi i tepricave të energjisë elektrike.
- o Qëllimi kryesor i Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike është që të projektojë përmbushjen e nevojave të konsumatorëve me energji elektrike, në sasi të mjaftueshme gjatë vitit, duke angazhuar kapacitetet e prodhimit dhe transmetimit në mënyrën sa më të mirë tekniko-ekonomike.



- o ZRRE pas vlerësimit të dokumentit ka paraqitur qëndrimet propozimet dhe ndyshimet e nevojshme rreth këtij dokumenti, ku pas përfshirjes së komenteve dhe propozimeve të palëve, dokumenti është propozuar për shqyrtim dhe aprovim.
- o ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të dokumentit ka konsideruar se janë përmbushur kriteret për aprovim, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2022

Bordi i ZRRE-së,

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Izet Rushiti, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Lutfie Dervishi, Anëtar

Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji